ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Qendrore e Prokruimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **UA/2016-23-9179-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me artikuj ushqimor**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**G.O.E Dauti Komerc SH.P.K & Dauti Komerc AD Saraj Shkup**
NUI	**810655524**
Adresa	**Gërlicë**
Vendi	**Ferizaj**
Kodi postar	**70000**
Numri Telefonit	**049/941/790**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ertan Kadri**
Adresa elektronike	**ertan.kadri@dauti-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**22.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara DAUTI KOMERC FERIZAJ

ДАУТИ КОМЕРЦ с.Бојане-Сарај 13

3. **Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit

1. Njoftimi për kontrate i datës 13.09.2023

2. Dosja e tenderit e datës 13.09.2023

3. Procesverbali i hapjes i datës 24.10.2023

4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 16.11.2023.

5. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 03.04.2024.

6. Kërkesapër rishqyrtim e datës 08.04.2024

6. Vendimi i AK – AQP, refuzimi i kërkesës për ri-shqyrtim i datës 15.04.2024

4. **Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

*6. **Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve***

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Grupi i OE ankues Dauti Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup me datën 08.04.2024, bazuar në nenin 108/A, të LPP-së, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim duke kundërshtuar vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit:Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit; me nr. te prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1, AK – AQP, me

datën 15.04.2024, me vendimit refuzon kërkesën tonë si të pabazuar duke mos kthyer përgjigje në pretendimet tona dhe duke mos marr parasysh faktet dhe dëshmitë e dorëzuara nga ana jonë, duke lënë në fuqi vendimin për eliminimin tonë edhe pse nuk është i bazuar në LPP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti

Neni 7 - Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Nenit 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 59 - Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Neni 60 - Kriteret e dhënies

Parimet e Prokurimit Publik

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik
Neni 40 -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 97- Shkeljet e Renda.

Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/2023
Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me njoftimin B58 te datës 03.04.2024 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: Agjencia Qendrore e Prokurimit ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me artikuj ushqimor - Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit; me nr. te prokurimit: UA/2016-23-9179-1-1-1, në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, Grup i Operatorëve Ekonomik Dauti Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup, përfaqësuar nga OE Dauti Komerc SH.P.K.; si lider i grupit me datën 08.04.2024, ka parashtruar kërkesëpër rishqyrtim dukekundërshtuar vendimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit sa i përket propozimit përdhënie tëkontratës në "Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit" të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me artikuj ushqimor", me nr prokurimi: UA/2016-23-9179-1-1-1. Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit AQP, sipas vendimit tëdatës 15.04.2024, ka refuzuar kërkesën tonëpër ri shqyrtim dhe ka lënë ne fuqi propozimin përdhënie të kontratës, përkundër faktit se ne kemi prezantuar prova dhe bazën ligjore përmes te cilës konfirmohet se ne jemi eliminuar në kundërshtim me kushtet ligjore dhe parimet e LPP-së dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kushtet e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, **prandaj duke besuar që OSHP në mandatin e saj do të luaj rrolin e gardianit të ligjit dhe mbi të gjitha gardianit të të mirës publike për çka ka edhe obligim ligjor duke mos lejuar keqpërdorimin dhe humbjen e plot 120,000.00 Eurove në total apo 30,000.00 Eurove në Lot 3 dhe 90,000.00 Eurove në Lot 5, në kuptim te nenit 109, te LPP-se dhe ne afatin e parapare paraqesim këtë:**

-

ANKESË

Pretendimi ankimor 1:

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP, me vendiminpër refuzim te kërkesës për rishqyrtim ka kryer shkelje ligjore të neni 108/A, te LPP-se, paragrafin 8,pika 4 citojmë: "8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi."
Paragrafi 9 citojmë : "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim."
Paragrafi 12 i nenit 108/A, te LPP-se:"Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në

përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë tëarsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe tëgjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë".
AK – AQP, në vendimin mbi shqyrtimin e kërkesës sonë për rishqyrtim nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona, nuk ka kthyer përgjigje në asnjërën prej çështjeve të ngritura nga ne. Dhe me këtë rast konsiderojmë që edhe për këtë pikë lënda duhet të kthehet në rivlerësim dhe përveç që duhet të respektohet nenin 59 i LPP-së gjatë vlerësimit të ofertave (siç është cekur më poshtë) duhet çdoherë të respektohet edhe nenin 108/A.

Pretendimi 2:

Eliminim jonë është i pabazuar ligjërisht.

Eliminimi jonë nuk bazohet në ligj por vetëm ceket që bazohet në vendim të OSHP-së, vendim ky jo i qartë ku bordi nuk jep asnjë vendim për ofertën tonë vetëm se ia falë besimin ekspertizës, ekspertizë kjo e cila gjithashtu nuk bazohet në ligj por qëllimisht keqinterpreton një përgjigje të KRPP-së dhekeqinterpreton nenet e ligjit kjo duke u bazuar në faktet:

Pyetja që i është bërë KRPP-së e që është e publikuar në e-prokurim është "*18. 22.11.2022 A lejohet një kompani të mbështet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup i operatorëve ekonomik?*" andaj shfrytëzimi i kësaj përgjigje në rastin tonë pa asnjë dyshimi është totalisht i qëllimshëm nga eksperti dhe me qëllim të vetme që mund të jetë përfitimet materiale të jashtëligjshmepër nevojat e veta, pasi që kjo pyetje nuk ka të bëjë asgjë me rastin e këtij aktiviteti të prokurimit pasi që nuk kemi të bëjmë me aplikimin e një kompanie dhe degëve të saj.

Keqinterpretimi i qëllimshëm i ligjit respektivisht nenit 71 pasi që Grupi jonë përbehet vetëm nga dy anëtare dhe që të dy i kemi dorëzuar të gjitha dokumentet që kërkohen për themelimin e grupit duke nënshkruar edhe marrëveshjen e kërkuar, edhe në këtë rast tentimi i ekspertit për të keqinterpretuar këtë nen ka për qëllim të vetëm dëmtimin e buxhetit në vlera jashtëzakonisht të mëdha pra në total 120,000.00 €. Neni 71 është për themelimin e Grupeve dhe oferta jonë është në përputhje të plotë me këtë nen.

Është i pakuptim citimi i nenit 68 ku ne si kompani plotësojmë këto kërkesa pasi që kemi qarkullime dhjetëra herë më të mëdha se kompania e rekomanduar për kontratë, dy anëtarët e grupit edhe në mënyrë vetanake plotësojnë këto kërkesa e aq më tepër si grup, por edhe këtu vërehet se citimi i këtyre neneve nga eksperti qëllimin e vetëm e ka pasur eliminimin tonë dhe të mundohet të bind të gjitha palët e interesit dhe organet kompetente të drejtësisë që veprimi i tij është i drejtë dhe të mos vërehet që kjo ekspertizë nuk është e bazuar në ligj dhe për më tepër tenton të dëmtoj buxhetin e shtetit për rreth 120,000€ në total apo rreth 30,000.00€ vetëm tek Lot 3.

Tek Kërkesa 3 Kapaciteti teknik dhe profesional: "*Kërkesa 3 Te gjitha produktet ushqimore me origjine shtazore , duhet te kenë origjinën, nga një ndërmarrje e aprovuar (licencuar) nga AUV-a (produktet vendore nga thertore qumështoret e licencuara ose aprovuara ose Fabrikat Prodhuese të Mishit te aprovuar) (produktet nga Importi nga subjektet depo ftohëse dhe mjete transportuese adekuate te aprovuara) - KËRKOHET VETËM PËR Lot 1,2 dhe 3." ; Evidenca 3 Si dëshmi e aprovimit Licenca ose Vendimi për Aprovim i lëshuar nga AUV për te gjitha ndërmarrjeve te biznesit me mish qumësht , - - KËRKOHET VETËM PËR Lot 1,2 dhe 3."* Është shumë e qartë që ka të bëjë me produktin, pra që ndërmarrja që prodhon atë produkt të ketë aprovimin/licencën nga AUV, dhe gjithashtu kërkohet edhe depo ftohëse të cilën ne e kemi dhe kemi ofruar dëshmi të qëndrueshme që produktet që ofrojmë janë të prodhuara nga ndërmarrje e licencuar/aprovuar nga AUV. Në të kundërtën nëse do të ishte kërkesa me të vërtetë ashtu siçështë tentuar të interpretohet atëherë kjo kërkese do të ishte e jashtëligjshme pasi që diskriminon të gjithë operatorët ekonomik që nuk janë prodhues, çështje kjo që bie ndesh edhe me praktikat ekonomike në të gjitha vendet e zhvilluara dhe që kanë një ekonomik të tregut të lirë ku në shumicën absolute të rasteve prodhuesit i prodhojnë produktet ndërsa distribuomi bëhet nga kompanitë e specializuara në këtë lami dhe jo nga kompani që kanë një apo dy dyqane dhe restorante por përmes ndikimit tek ekspertet e OSHP-së përfitojnë edhe kontrata publike me çmime shumë më të larta se konkurrentet që janë të specializuar në fushën e distribouimit.

Është më se i qëllimshëm citimi jo i plotë i Nenit 59 paragrafi 4 i LPP-së që i bënë eksperti, ku citimi i tij është: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*" Por ky paragraf vazhdon edhe më tutje dhe si i plotë është: "*4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve*" ky shkurtim i këtij paragrafi gjatë citimit është i qëllimshëm pasi që nuk mund të arsyetoj që "devijimet" e ofertës tonë (kjo sipas eksperti) çfarë rëndësie materiale kanë dhe çfarë ndikimi material do të mund të kishin në kontratë përveç asaj që do të kursehen mbi 120,000.00 Euro.

Të gjitha këto fakte tregojnë që ekspertiza kishte qëllim të vetëm eliminimin tonë dhe arritjen e kontratave me vlere mbi 120,000.00 euro më shumë se oferta jonë, para këto që pa të drejtë ju shpenzohen qytetarëve dhe dërgohen në duart e disa personave.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura është e padrejtë që dy organet kryesore të

prokurimit publik të manipulohen nga një ekspert. Është e kuptueshme që pagesat si të ekspertit ashtu edhe të stafit të OSHP-së apo AQP-së janë në raport të padrejte me vlerën që kanë kontrata për të cilat ata duhet të marrin vendime por gjithsesi do të duhej të ruajë integriteti personal por edhe institucional, sidomos ai i AQP-së në të cilin kishim besim të palëkundur deri në këtë rast.

Është e padrejtë për të gjithë operatoret ekonomik por edhe për sistemin e prokurimit publik që institucionet qendrore si OSHP dhe AQP ti nënshtrohen një eksperti të dyshimtë duke dalur kështu këto dy institucione nga mandati i tyre për çka edhe ekzistojnë.

Shkeljet e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,

Shkelja e Nenit 1.
Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në Nenin 1 Qëllimi, paragrafi 1: "**Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese** në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla." Dhe paragrafi 3 "**Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale**, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, **duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike** ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji."
Me eliminimin tonë në Lot 3 AQP ka shkelur Nenin 1 të LPP-së, kjo për arsye se është rekomanduar të shpërblehet me kontratë një OE që në total për Lot 3 ka çmimin më të lartë se oferta jonë për mbi 30,000.00€ e ku duhet të ceket që i gjithë ky dëmtim i buxhetit publik është vetëm për një periudhë 12 mujore dhe për produktet e njëjta. Pra AQP duke u bazuar në vendim të OSHP-së, vendim i cili është i bazuar vetëm në një ekspertizë e cila vërehet qartë që deformon ligjin për të ardhur deri tek eliminimi jonë dhe dërgimi i kontratës tek një OE me çmim 120,000.00€ më të lartë ka shkelur edhe paragrafin e 3 të Nenin 1 të lartcekur pasi që nuk ka asnjë arsye tjetër për këtë vendim përveç interesave materiale që dyshojmë se fillon që nga eksperti i cili ka hartuar një ekspertizë të padrejtë.

Shkelje e të gjitha Parimeve të LPP-së.

Shkelja e Nenit 6 dhe Nenit 7

Neni 6 paragrafi 1: "**Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,** njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit." Në rastin konkret me eliminimin tonë është rekonaduar të shpërblehet me kontratë një OE i cili ofron të njëjtat produkte duke arritur qëllimin dhe lëndën e njëjtë të prokurimit vetëm se me 30,000.00€ më shumë që në kundërshtim të plotë me nenin e lartcekur. Si dhe ka shkelje të nenit 7 pasi që ne jemi diskriminuar duke u eliminuar me një kërkesë e cila është për produktin dhe jo për kompaninë dhe është plotësuar ashtu siç edhe është kerkuar.

Shkelja e Nenit 54 Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Paragrafi 1.2 "në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.", është shkelur ky nen për arsye se ne nuk jemi informuar se mbi cilën bazë ligjore jemi eliminuar, pra në bazë të cilit nen të LPP-së jemi eliminuar dhe çfarë ka munguar në ofertën tonë.

Shkelja e Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Në veçanti e paragrafit 4 "***Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***" Kjo është edhe baza mbi të cilën do të duhej të bëhej vlerësimi i ofertave apo baza mbi të cilën të gjitha AK-të janë të obliguara të kryejnë vlerësimin e ofertave. Me këtë rast ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Për Lot 5 është në kundërshtim të plotë me këtë Nen eliminimi jonë pasi që kemi plotësuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe eliminimi jonë është i papranueshme për ne por do të duhej të ishte i papranueshme për të gjith zyrtarët e ndershëm dhe të përgjegjshëm pasi që me eliminimin tonë vetëm nga Lot 5 buxheti i Republikës së Kosovës dëmtohet apo zhvatet me rreth 90,000.00€. Për Lot 3 ka mundur të ketë moskuptim nga ana e komisionit të vlerësimit se pse janë futur në ofertë disa dokumente dhe teste të produkteve të prodhuesit "Abrazen" por që është sqaruar në deklaratën tonë të dorëzuar me datën 02.11.2023 ku edhe ceket që është deklaratë për Lot 3 e që sqaron se këto dokumente janë bashkangjitur vetëm për të siguruar AK se produktet e ofruara nga ne përmbushin të gjitha standardet e aplikuara në Republikën e Kosovës dhe nuk ka asnjë qëllim që të mbështetemi në kapacitetet e ndonjë kompanie tjetër për të plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë pasi që të gjitha i kemi plotësuar vetëm me kapacitetet tona.
Në asnjë rast LPP e në veçanti nenin 59 nuk parasheh që të vlerësohen ofertat bazuar në

ekspertizën e një eksperti të dyshimtë por në secilin rast kërkohet që vlerësimi të bëhet vetëm me kushtet e paraqitura në Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit e që në rastin konkret është shkelur ky nen pasi që ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Shkelja e Nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Paragrafi 1 "Autoritetikontraktues dot'iajapkontratënpublike operatorit ekonomikqëka dorëzuarose:1.1tenderin epërgjegjshëmme çmiminmëtë ulët;" duke pasur parasysh që ky ishte kriteri i dhënies në këtë aktivitet të prokurimit dhe duke pasur parasysh që Ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit konsiderojmë se është shkelur ky nen duke rekomanduar për kontratë një operatorë tjetër i cili kishte çmimin 30,000.00€ më të lartë se Ne.

Dëshirojmë ta bëjmë të qartë se OE"ABRAZEN" nuk është anëtari i grupit tonë dhe nuk jemi mbështetur në kapacitetet e tij si dhe në rast se ne shpërblehemi me kontrate të gjitha obligimet e kontratës do ti bartim ne si grup dhe asnjë obligim kontraktual nuk është i OE"ABRAZEN", kjo besojmë që është e qarte dhe kërkojmë që të mos keqinterpretohet me qëllim të dëmtimit të kompanisë sonë por edhe buxhetit të Republikës së Kosovës.

Pretendimi Ankimor 3:

Anëtari i Grupit të rekomanduar për kontrate "N.P.T HAJDINI COMERC" ka paraqitur ISO 22000:2018 që fillimisht ka pasur afat vetëm deri me datën 15.01.2024 pra në fazën e ri-vlerësimit nuk ka qenë valid ky ISO standard, por gjithsesi në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuara për Lot 3 - për qumësht, pra ISO 22000:2018 - për qumësht, ndërsa në gamen e ISO të dorëzuar nga OE i lartcekur nuk figurojnë produktet e qumështit të cilat për dallim nga produktet tjera duhet të transportohen me pajisje transportuese frigo, por gjithsesi nuk ka plotësuar kriterin duke pasur ISO jo atë që është kërkuar por gjithashtu duke e pasur ISO me afat të skaduar, për më tepër dokumenti ISO i pranuar gjatë qasjes në dokumente ka një QR code i cili nuk hapet, pra nuk mund të verifikohet, me këtë rast konsiderojmë që komisioni i vlerësimit nuk ka verifikuar fare këtë ISO të paraqitur nga OE i lartcekur.

Qarkullimi total i deklaruar nga "N.P.T HAJDINI COMERC" me CD ka vlerën e 8.2 milion euro në tri vitet e fundit ndërsa tek referencat per tri vitet e fundit ka deklaruar mbi 8.7 milion euro. Kjo përveç që sjelle dyshime të mëdha se si është e mundur një gjë e tillë gjithashtu sjellë ndërmend dhe duhet të ceket që kjo kompani të gjithë qarkullimin e saj e ka përmes kontratave me sektorin publik dhe për më tepër vetëm me 3 institucion që janë AQP, Shërbimi korrektues dhe Policia e Kosovës. Apo rreth 2.8 milion euro ka siguruar qarkullim vetëm nga kontratat e AQP-së e që në raport me qarkullimin total të tij është mbi 35%, një gjë e tillë në një shtet të zhvilluar nuk do të konsiderohej si normale pasi që

pikërisht kjo është konkurrencë jo e drejtë dhe me tendenca të shkuarjes në drejtim të oligarkisë ku vetëm një grup i caktuar i OE-ve përfitojnë nga kontratat shtetërore dhe nuk ju jepet mundësia OE-ve të tjerë si në rastin konkret ku ne eliminohemi pa asnjë bazë ligjore.

Pretendimi Ankimor 4:

Kërkesa 3 tek kërkesat mbi Kapacitetin teknik dhe profesional: "*Te gjitha produktet ushqimore me origjine shtazore , duhet te kenë origjinën, nga një ndërmarrje e aprovuar (licencuar) nga AUV (produktet vendore nga thertore qumështoret e licencuara ose aprovuara ose Fabrikat Prodhuese të Mishit te aprovuar) (produktet nga Importi nga* ***subjektet depo ftohëse*** *dhe mjete transportuese adekuate te aprovuara) - KËRKOHET VETËM PËR Lot 1,2 dhe 3.*"
Ne kemi dëshmuar që kemi depo ftohëse të aprovuar nga institucioni kompetent AUV dhe në këtë rast plotësojmë të gjitha kushtet e kërkuar për një distributor.

Nëse kërkesa keqinterpretohet dhe i jepet kahje e tillë që vetëm ndërmarrjet e aprovuara nga AUV mund të fitojnë këtë kontratë atëherë konsiderojmë që është shkelje ligjore pasi që na diskriminon të gjithë ne OE-të e tjerë dhe si e tillë nuk duhet të lejohet një gjë e tillë.

Kërkojmë që të **mos caktohet** ekspert i kësaj lënde Fatmir Krasniqi pasi që në të kaluarën Ne kemi pasur kontrata me të njëjtin (ku ai ka qenë në pozitën e ZPP-së) pra ka qenë nënshkrues i kontratave tona dhe kemi dyshime siç është sqaruar më lart se i njëjti me qellim të ndryshme dhe të ulëta qëllimisht ka vepruara në kundërshtim me parimet e LPP-së me qëllim të dëmtimit të buxhetit publik në vlerën prej 130,000.00€. Andaj kërkojmë që të caktohet ndonjë ekspert tjetër.

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara më larte, grupi i OE ankues Grup i Operatorëve Ekonomik Dauti Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup: konsideron se AK - AQP, vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara propozojmë që eksperti shqyrtues ne kuptim te dispozitave te nenit 113 te LPP-se, të trajtoje pretendimet tona ankimore ne kuptim te asaj se çfarë ne kemi kërkuar, ne mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

VENDIM

- Te aprovohet si e bazuar, ne tërësi ankesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik Dauti

Komerc SH.P.K.; Dauti Komerc AD Saraj Shkup

- Te kthehet lënda ne Rivlerësim dhe te rekomandohet për dhënie te kontratësOE ankues,

- Te obligohet AK AQP, qe gjatë ri vlerësimit e ofertave ti respektoj ne tërësidispozitat ligjore.

- Te lejohet kthimi i mjeteve te deponuara ne emër te ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e fitimit të planifikuar prej rreth 10% (që mund të dëshmohet edhe nëse analizoni deklarimet tona në ATK ku fitimin vjetor e kemi rreth 10% dhe për të cilin paguaj tatimin dhe jo si disa kompani tjera që fitimin në fund e kanë më të ulët se 3% por kërkojnë kompenzim dëmi me 10%). Kostot e sigurimit të tenderit, angazhimi i stafit, stresi dhe ndikimet në moralin e kompanisë me humbjen e një kontrate të cilën ligjërisht e kemi fituar duke ofruar çmimin më të ulët dhe duke plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*